



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.18

Datë 8 mars 2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9472 datë 9.2.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Konventës “Për ndalimin ose kufizimin e përdorimit të armëve të quajtura konvencionale, të cilat mund të konsiderohen se shkaktjnë dëmtime të mëdha ose pasoja pa dallim”.....	577
Ligj nr.9473 datë 9.2.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Austrisë, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Çekisë, Republikës së Hungarisë, Republikës së Polonisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Sllovakisë dhe Republikës së Sllovenisë për mbështetjen e bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë, në kuadër të programit të shkëmbimeve të studimeve universitare për Europën Qendrore (CEEPUS) II”.....	578
Ligj nr.9476 datë 9.2.2006	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar.....	584
Ligj nr.9477 datë 9.2.2006	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.....	585
Vendim i Kuvendit nr.22, datë 27.2.2006	Për mosmiratimin e raportit për veprimtarinë vjetore të Këshillit Kombëtar të Radios dhe të Televizionit.....	586
	Rezolutë e Kuvendit për raportin vjetor të Këshillit Kombëtar të Radios dhe të Televizionit për vitin 2005.....	586
	Rezolutë e Kuvendit për veprimtarinë e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave gjatë vitit 2005.....	587

Vendim i KKRT nr.416, datë 28.2.2006	Për heqjen e licencës së radio “Stinët”	589
Vendim i KKRT nr.417, datë 27.2.2006	Për dhënie licence për radio vendore private “X”	591
Vendim i KKRT nr.418, datë 27.2.2006	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “Ir-Gen”	592
Vendim i KKRT nr.419, datë 27.2.2006	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “Eri A&A”	592
Vendim i KKRT nr.420, datë 27.2.2006	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “K.A.M”	593
Vendim i KKRT nr.421, datë 27.2.2006	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “Ali Pashë Tepelena” (“APT”).....	593
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Arben Roda.....	594

L I G J
Nr.9472, datë 9.2.2006

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË AMENDAMENTIN E KONVENTËS
“PËR NDALIMIN OSE KUFIZIMIN E PËRDORIMIT TË ARMËVE TË QUAJTURA
KONVENCIONALE, TË CILAT MUND TË KONSIDEROHEN SE SHKAKTOJNË
DËMTIME TË MËDHA OSE PASOJA PA DALLIM”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në amendamentin e Konventës “Për ndalimin ose kufizimin e përdorimit të armëve të quajtura konvencionale, të cilat mund të konsiderohen se shkaktojnë dëmtime të mëdha ose pasoja pa dallim”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4794, datë 3.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA

**MBI NDALIMIN OSE KUFIZIMIN E PËRDORIMIT TË DISA ARMËVE TË CAKTUARA
KONVENCIONALE, TË CILAT MUND TË KONSIDEROHEN SE SHKAKTOJNË DËMTIME TË
RËNDA OSE SJELLIN PASOJA PA DALLIM**

Gjenevë, 10 tetor 1980
Amendament i nenit 1-21.12.2001

Neni 1

Qëllimi kryesor i zbatimit

Kjo Konventë dhe protokollet e aneksuara do të zbatohen në situata të cilat përmenden në nenin 2 të konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 për mbrojtjen e viktimave të luftës, përfshirë çdo situatë të përshkruar në paragrafin 4 të nenit 1 të protokollit të parë shtesë të këtyre konventave.

Kjo Konventë dhe protokollet e aneksuara do të zbatohen gjithashtu, përveç situatave të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, edhe në situatat që referohen në nenin 3, e përbashkët të konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949. Kjo Konventë dhe protokollet e aneksuara të saj nuk do të zbatohen për situatat në konfliktet dhe tensionet e brendshme, si për shembull RIOTS, aktet e izoluar dhe sporadike të dhunës, dhe akte të tjera të një natyre të ngjashme, për sa kohë që nuk janë konflikte të armatosura.

Në rastin e konflikteve të armatosura që nuk kanë karakter ndërkombëtar, që ndodhin në territorin e njërit prej Shteteve Palë Kontraktuese, secila palë në konflikt do të detyrohet të zbatojë

ndalimet dhe kufizimet e kësaj Konvente dhe protokollet e aneksuara të saj.

Asgjë në këtë Konventë ose në protokollet e aneksuara të saj nuk do të kuptohet si justifikim për qëllimin e prekjës së sovranitetit të një shteti ose përgjegjësisë së qeverisë, përmes gjithë mjeteve të ligjshme, të mirëmbajnë ose të rivendosin rregullin dhe ligjin në shtetin e tyre ose atë mbrojnë unitetin kombëtar dhe integritetin territorial të shtetit.

Asgjë në këtë Konventë ose në protokollet e aneksuara të saj nuk do të kuptohet si justifikim për qëllim të ndërhyrjes direkte ose jo, për çfarëdo arsye, në një konflikt të armatosur ose në punët e brendshme ose të jashtme të Shteteve Palë Kontraktuese në territorin e së cilës ndodh konflikti.

Zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente dhe protokolleve të aneksuara të saj për palët në një konflikt, të cilat nuk janë Shtete Palë Kontraktuese që kanë pranuar këtë Konventë ose protokollet e aneksuara të saj, nuk do të ndryshojnë statusin e tyre ligjor ose statusin ligjor të vendeve në konflikt në mënyrë të hapur ose jo.

Dispozitat e paragrafëve 2 deri 6 të këtij neni nuk do të cenojnë protokollet shpesh të adoptuara pas 1 janarit 2002, të cilat mund të zbatohen, të përjashtojë ose modifikojë qëllimin e zbatimit të tyre për sa i përket këtij neni.

L I G J
Nr.9473, datë 9.2.2006

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN NDËRMJET
REPUBLIKËS SË AUSTRIËS, REPUBLIKËS SË BULLGARISË, REPUBLIKËS SË
KROACISË, REPUBLIKËS SË ÇEKISË, REPUBLIKËS SË HUNGARISË, REPUBLIKËS SË
POLONISË, REPUBLIKËS SË RUMANISË, REPUBLIKËS SË SLOVAKISË DHE
REPUBLIKËS SË SLOVENISË PËR MBËSHTETJEN E BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E
ARSIMIT TË LARTË, NË KUADËR TË PROGRAMIT TË SHKËMBIMEVE TË
STUDIMEVE UNIVERSITARE PËR EUROPËN QENDRORE (CEEPUS) II”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Austrisë, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Çekisë, Republikës së Hungarisë, Republikës së Polonisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Sllovakisë dhe Republikës së Sllovenisë për mbështetjen e bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë, në kuadër të programit të shkëmbimeve të studimeve universitare për Europën Qendrore (CEEPUS) II”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4795, datë 3.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE

**MIDIS REPUBLIKËS SË AUSTRIËS, REPUBLIKËS SË BULLGARISË, REPUBLIKËS SË
KROACISË, REPUBLIKËS SË ÇEKISË, REPUBLIKËS SË HUNGARISË, REPUBLIKËS SË**

POLONISË, REPUBLIKËS SË RUMANISË, REPUBLIKËS SË SLLOVAKISË DHE
REPUBLIKËS SË SLLOVENISË PËR MBËSHTETJEN E BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E
ARSIMIT TË LARTË NË KUADRI E PROGRAMIT TË SHKËMBIMIT TË STUDIMEVE
UNIVERSITARE PËR EUROPËN QENDRORE (“CEEPUS II”)

Republika e Austrisë, Republika e Bullgarisë, Republika e Kroacisë, Republika e Çekisë,
Republika e Hungarisë, Republika e Polonisë, Republika e Rumanisë, Republika e Sllovakisë dhe
Republika e Sllovenisë, këtu të quajtura “Palë Kontraktuese”,
kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1

Palët Kontraktuese do të mbështesin bashkëpunimin në fushën e arsimit të lartë, në veçanti
bashkëveprimin ndëruniversitar dhe qarkullimin në kontekstin e zbatimit të CEEPUS II. Veprimet e
programit CEEPUS II janë paraqitur në shtojcën I, që është pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

1) Në këtë Marrëveshje, termi “Universitet” i referohet një institucioni që siguron arsimin e
lartë dhe që njihet nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, si pjesë e sistemeve të tyre të
arsimit të lartë.

Secila Palë Kontraktuese do të bëjë çdo vit një listë të universiteteve të pranueshme për
CEEPUS II.

2) Në këtë Marrëveshje, termi “vit akademik” i referohet periudhës kohore nga 1 shtatori deri
më 31 gusht të vitit tjetër.

3) Studentët e regjistruar në universitete, pa marrë parasysh se në cilën fushë studimi, janë të
pranueshëm për mbështetje në kuadrin e programit CEEPUS II, deri në dhe duke përfshirë nivelin e
doktoraturës ose pasuniversitar, nëse periudha e studimit apo e specializimit e bërë në përputhje me
këtë Marrëveshje në një universitet ose institucion pritës, i cili është i pajtueshëm me kurrikulën e
universitetit të vendit prej nga vjen studenti, është pjesë e studimeve të tij/saj universitare.

Gjithashtu, programi CEEPUS II do të mbështesë qarkullimin e personelit mësimdhënës të
universiteteve, për të nxitur bashkëpunimin ndëruniversitar transkombëtar dhe për të përmirësuar
dimensionin e kurrikulës universitare në Europën Qendrore.

Programi CEEPUS II nuk mbulon veprimtaritë e kërkimit dhe të zhvillimit teknologjik.

Neni 3

1) Do të ngrihet një Komitet i Përbashkët i Ministrave, ku secili ministër përfaqëson një nga
Palët Kontraktuese. Komiteti i Përbashkët i Ministrave do të jetë përgjegjës për të gjitha hapat dhe
vendimet e nevojshme për zbatimin dhe mbështetjen e programit CEEPUS II, për miratimin e
raporteve të vlerësimit dhe ristrukturimin e programit.

2) Komiteti i Përbashkët i Ministrave do të mbledhet të paktën një herë në vit. Ministrat që nuk
mund të marrin pjesë në mbledhje do të përfaqësohen nga zyrtarë të lartë. Komiteti i Përbashkët i
Ministrave mund të caktojë një grup zyrtarësh të lartë për të diskutuar për çështje që Komiteti i
Përbashkët i Ministrave u ka caktuar lidhur me përgatitjen e takimit tjetër të Komitetit të Përbashkët të
Ministrave.

3) Komiteti i Përbashkët i Ministrave do të zgjedhë një kryetar nga anëtarët e tij për një
periudhë njëvjeçare.

4) Komiteti i Përbashkët i Ministrave do të bëjë përpjekje që të arrijë marrëveshje me
konsensus për çdo vendim, për të siguruar zbatimin dhe promovimin e programit, siç përshkruhet në
shtojcën I. Në rast se nuk bihet dakord, vendimi për çështjen do të merret me dy të tretat e shumicës së
anëtarëve të Komitetit të Përbashkët të Ministrave të pranishëm dhe që votojnë.

5) Lidhur me buxhetin vjetor të të gjitha Palëve Kontraktuese dhe shkëmbimin e kuotave,
domethënë numrin e bursave mujore për vit akademik, secila Palë Kontraktuese, për të lehtësuar

veprimet e përshkruara në shtojcën I, do të bëjë propozime. Komiteti i Përbashkët i Ministrave merr një vendim përfundimtar të përgjithshëm unanim për të gjitha propozimet.

Neni 4

1) Të gjitha vendimet për përzgjedhjen e projekteve të përshkruara në shtojcën I (Veprimet 1-3) do të merren nga Komiteti i Përbashkët i Ministrave ose nga grupi i zyrtarëve të lartë, siç parashikohet në nenin 3. Stafi akademik ose ekspertë të tjerë do të konsultohen për mbështetjen e procesit të përzgjedhjes.

2) Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, çdo Palë Kontraktuese do të emërojë një përfaqësues kombëtar të zyrës CEEPUS, me përgjegjësitë e mëposhtme dhe do të njoftojë për këtë Komitetin e Përbashkët të Ministrave:

- njoftimet me qëllim promovimin e programit në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën Qendrore të CEEPUS-it dhe të gjithë përfaqësuesit e tjerë kombëtarë të zyrës CEEPUS;

- pranimin e aplikimeve;

- përgatitje e dhënies së bursave aplikantëve;

- sigurimin e një vendi studimi për bursistët e rinj;

- dhënien e bursave (shih shtojcën I dhe veprimin 4);

- organizimin e pagesës së bursave;

- marrjen e raporteve;

- zbatimin e vlerësimit kombëtar të programit;

- raportet vjetore.

3) Çdo Palë Kontraktuese do të marrë masa për të siguruar që përfaqësuesi kombëtar i zyrës CEEPUS të ketë në dispozicion mjetet e nevojshme për përmbushjen e funksioneve të veta.

Neni 5

1) Një Zyrë Qendrore e CEEPUS-it do të vendoset në Vjenë. Zyra Qendrore CEEPUS do të ketë fuqi ligjore në masën e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj. Zyra Qendrore CEEPUS, personeli i saj dhe përfaqësuesit e Palëve Kontraktuese të Zyrës Qendrore të CEEPUS—it do të gëzojnë privilegje dhe imunitet në masën e nevojshme për funksionet e tyre.

2) Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës Qendrore CEEPUS do të zgjidhet me shumicë vote me dy të tretat e Komitetit të Përbashkët të Ministrave për një periudhë pesëvjeçare me propozimin e Republikës së Austrisë.

Sekretari i Përgjithshëm mund të largohet nga detyra e tij para mbarimit të afatit me vendimin unanim të Komitetit të Përbashkët të Ministrave.

3) Infrastruktura e nevojshme, duke përfshirë pagesën e Sekretarit të Përgjithshëm dhe personelit të Zyrës Qendrore të CEEPUS-it, do të financohen nga Republika e Austrisë. Çdo Palë Kontraktuese ka të drejtë të punësojë personel shtesë në këtë zyrë me shpenzimet e saj.

Sekretari i Përgjithshëm do të caktojë rregulloren e Zyrës Qendrore CEEPUS dhe do të njoftojë për këtë Komitetin e Përbashkët të Ministrave.

4) Zyra Qendrore CEEPUS do të shërbejë vetëm si një strukturë koordinuese dhe vlerësuese, ndërsa Palët Kontraktuese do të kenë fuqi të plotë mbi buxhetin kombëtar për qarkullimin dhe veprimet e shkëmbimit të përshkruara në shtojcën I.

5) Zyra Qendrore CEEPUS:

- do të përgjigjet për zhvillimin e një strategjie të përbashkët të marrëdhënieve publike për programin dhe do të njoftojë Palët Kontraktuese për çështje informative;

- do të botojë informacione për universitetet e Palëve Kontraktuese, me qëllim mbështetjen e qarkullimit akademik mes tyre;

- do të përgjigjet për përgatitjen e një raporti mbi ecurinë vjetore dhe do të zbatojë vlerësimin e përgjithshëm të programit CEEPUS II;

- do të paraqesë propozime për zhvillimin e mëtejshëm të programit;

- do të jetë përgjegjëse për përgatitjen, organizimin dhe mbajtjen e protokolleve të takimeve të

Komitetit të Përbashkët të Ministrave;

- me kërkesë, do të mbështesë zbatimin dhe vendimet e marra nga Komiteti i Përbashkët i Ministrave.

Neni 6

1) Palët Kontraktuese do të përpiqen të mos pengojnë me asnjë mjet lëvizjen e lirë dhe qëndrimin e personave që marrin pjesë në lëvizjet qarkulluese të mbuluara nga kjo Marrëveshje.

2) Palët Kontraktuese bien dakord të marrin masa që i konsiderojnë të përshtatshme në kuadrin e ligjeve të tyre kombëtare, me qëllim shmangien e të gjitha pengesave administrative dhe financiare për marrje vize, lejeqëndrimi për përfituesit e bursave CEEPUS II.

Neni 7

1) Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë pesëvjeçare. Mund të rinovohet për një periudhë më të gjatë me marrëveshjen e Palëve Kontraktuese. Rishikimi i kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhet para përfundimit të vitit të tretë akademik pas hyrjes së saj në fuqi. Ky rishikim do të bazohet në një vlerësim të përgjithshëm të programit CEEPUS II.

2) Secila Palë Kontraktuese mund të kërkojë, në çdo kohë, një rishikim të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim, ajo duhet t'i dorëzojë një kërkesë me shkrim kryetarit të Komitetit të Përbashkët të Ministrave dhe Palëve të tjera Kontraktuese. Çdo vendim që lidhet me rishikimin e kësaj Marrëveshjeje do të bëhet me vendimin unanim të Komitetit të Përbashkët të Ministrave.

Neni 8

1) Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim në Zagreb të Kroacisë nga data 9 mars 2003 deri më 9 mars 2003, për Republikën e Austrisë, Republikën e Bullgarisë, Republikën e Kroacisë, Republikën e Çekisë, Republikën e Hungarisë, Republikën e Polonisë, Rumaninë, Republikën e Sllovakisë dhe Republikën e Sllovenisë. Ajo do të jetë e hapur për zgjerim.

2) Kjo Marrëveshje dhe rishikimet e saj do t'i nënshtrohen miratimit nga Palët Kontraktuese dhe dokumentet e miratimit do të depozitohen në Ministrinë e Arsimit të Hungarisë, të quajtur në këtë Marrëveshje si "Depozituesi".

3) Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të tretë pas depozitimit të dokumenteve të miratimit nga jo më pak se tri Palë Kontraktuese.

4) Çdo shtet që nuk është përmendur në paragrafin 1, mund të pranohet me ftesën unanime të Komitetit të Përbashkët të Ministrave. Çdo shtet që dëshiron të bëhet Palë Kontraktuese duhet të njoftojë Depozituesin me shkrim për qëllimin e tij.

5) Depozituesi do të informojë të gjitha Palët Kontraktuese për njoftimet dhe dokumentet e miratimit të paraqitura.

6) Çdo shtet që bëhet Palë Kontraktuese pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të ketë pjesëmarrje të plotë në aktivitetet e programit, siç përshkruhen në shtojcën 1, vetëm pas vendimit unanim të Komitetit të Përbashkët të Ministrave.

Neni 9

Një Palë Kontraktuese mund të tërhiqet në çdo kohë nga kjo Marrëveshje, duke njoftuar me parë me shkrim Depozituesin. Çdo tërheqje do të fuqizohet me përfundimin e të paktën 6 muajve nga data e marrjes së njoftimit për tërheqje nga Depozituesi; sidoqoftë, Komiteti i Përbashkët i Ministrave mund të caktojë një periudhë më të gjatë se 6 muaj, por më të shkurtër se 12 muaj, për hyrjen në fuqi të tërheqjes së lajmëruar.

Neni 10

1) Çdo mosmarrëveshje midis dy ose më shumë Palëve Kontraktuese, ose midis njëres prej tyre dhe Zyrës Qendrore CEEPUS, që ka të bëjë me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje

apo shtojcës së saj, e cila nuk mund të zgjidhet nga Komiteti i Përbashkët i Ministrave, mundet t'i nënshtrohet gjyqimit me kërkesën e çdo pale për këtë mosmarrëveshje.

2) Trupi gjykues do të përbëhet nga së paku 3 anëtarë. Secila palë që ka mosmarrëveshje do të caktojë një gjykatës: dy gjykatësit e parë do të caktojnë gjykatësin e tretë, i cili do të jetë kryetari i trupit gjykues.

3) Trupi gjykues do të caktojë vendin ku do të vendoset dhe do të përcaktojë vetë rregulloren e procedurës.

4) Vendimi i trupit gjykues do të merret nga shumica e anëtarëve të tij, të cilët nuk mund të jenë asnjans në votim. Ky vendim do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për të gjitha palët që kanë mosmarrëveshje dhe s'mund të ketë apel kundër tij. Palët do ta pranojnë vendimin menjëherë. Në rast mosmarrëveshjeje, si për kuptimin dhe shtrirjen e tij, trupi gjykues do ta interpretojë vendimin me kërkesë të secilës palë të përfshirë në mosmarrëveshje.

Neni 11

Teksti origjinal i kësaj Marrëveshjeje, që është teksti në gjuhën angleze do të depozitohet te Depozituesi.

Me besim që nënshkruesit janë të autorizuar për këtë qëllim, kanë firmosur këtë Marrëveshjeje.

Nënshkruar në Zagreb, Kroaci, më 9 mars 2003.

CEEPUS II: Shtojca I

Palët Kontraktuese do të zhvillojnë dhe mbështesin një rrjet universitar të Europës Qendrore të përbërë nga rrjete të ndryshme individuale. Ky rrjet ka si qëllim të nxisë qarkullimin studentor, sidomos qarkullimin studentor brenda Europës Qendrore, dhe të mbështesë bashkëpunimin universitar në Europën Qendrore, si dhe zhvillimin e programeve të përbashkëta që teorikisht, shpien në diplomim të dyfishtë apo të përbashkët.

Të gjitha veprimet e CEEPUS II, me përjashtim të bursave të lira (jashtë rrjetit), do të bëhen në kuadër të rrjeteve CEEPUS II, siç përshkruhet në veprimin 1.

CEEPUS II do t'u japë përparësi rrjeteve që zhvillojnë bashkëpunimin e tyre në programe të përbashkëta ose në programe të reja të përbashkëta për zhvillim. Komiteti i Përbashkët i Ministrave do të mbikëqyrë ecurinë e arritur me Procesin e Bolonjës nga kjo pikëpamje dhe në përputhje me të, do të caktojë përparësitë CEEPUS II.

Veprimi 1: Vendorsja dhe funksionimi i një rrjeti universitar të Europës Qendrore.

1) Një rrjet do të përfshijë të paktën 3 universitete, dy prej të cilëve u përkasin Palëve të ndryshme Kontraktuese, ndonëse rrjetet e specializuara në zhvillimin e programeve të përbashkëta mund të përfshijnë vetëm dy universitete të dy Palëve Kontraktuese të ndryshme për një fazë të parë që do të caktohet nga Komiteti i Përbashkët i Ministrave. Sidoqoftë, përparësi do t'u jepet rrjeteve që përbëhen nga më shumë se dy universitete të Palëve të ndryshme Kontraktuese.

2) Çdo universitet që dëshiron të marrë pjesë në rrjetin CEEPUS II duhet të plotësojë këto kërkesa:

a) Periudha e studimit ose e trajnimit e kryer në një universitet pjesëmarrës ose institucion pritës do të njihet plotësisht në universitetet partnere.

b) Njohja e ndërsjellt brenda rrjetit do të parashikohet. Do të zbatohet ECTS (Sistemi Europian i Transferimit të Krediteve) apo sisteme të pajtueshme me të. Në rastin e studentëve që punojnë për tezat ose dizertacionet, kjo do të zëvendësohet nga një deklaratë e përbashkët nga drejtuesi i punimit vendas dhe ai i universitetit pritës, që studimi jashtë shtetit gjatë kësaj periudhe ka shërbyer për punimin e tezës apo dizertacionit.

c) Për të lehtësuar qarkullimin akademik, kurset dhe/ose leksionet e CEEPUS II do të bëhen gjithashtu në gjuhën angleze, gjermane ose frënge.

Palët Kontraktuese bien dakord për të mbështetur kurset profesionale për gjuhët duke dhënë bursa mujore për kurse përgatitore profesionale për gjuhët angleze, gjermane dhe frënge, të ofruara nga rrjetet përkatëse.

Kurset e gjuhës mund të shoqërohen me kurse në gjuhën e vendit pritës, kur kjo është e mundur.

d) Një student që studion brenda kuadrit të CEEPUS II do të përjashtohet nga taksat e regjistrimit apo/dhe shkollimit.

Veprimi 2: Kurset intensive

Palët Kontraktuese bien dakord të promovojnë kurse intensive me qëllim që:

1) Këto kurse të kenë si synim të tërheqin pjesëmarrës nga sa më shumë Palë Kontraktuese, duke përfshirë dhe vendin pritës. Pjesëmarrësit mund të jenë studentë dhe/ose lektorë, profesorë lëvizës apo personel mësimdhënës.

2) Këto kurse janë klasifikuar si:

Kurse verore për një periudhë të paktën 10 ditë pune për një temë të veçantë, me kusht që të kenë pikë krediti.

Kurse intensive trajnimi për një periudhë të paktën 10 ditë pune për personelin e ri mësimdhënës.

3) Kongrese dhe veprimtari të ngjashme përjashtohen kategorikisht.

Veprimi 3: Ekskursionet studentore

Palët Kontraktuese bien dakord të nxisin ekskursionet e studentëve, me kusht që këto ekskursionet të kenë pikë krediti dhe:

1) të shërbejnë për qëllime shkencore/artistike dhe të përdorin një pjesë të caktuar të infrastrukturës së vendit pritës; ose

2) të shërbejnë për një qëllim shkencor/artistik dhe të organizohen bashkërisht.

Veprimi 4: Skema e qarkullimit të bursave të studentëve dhe mësuesve

1) Palët Kontraktuese bien dakord t'u japin bursa individuale studentëve që marrin pjesë në veprimtaritë e CEEPUS II të përshkruara në veprimin 1-3.

2) Bursa do t'u jepen gjithashtu lektorëve, profesorëve lëvizës dhe personelit mësimdhënës, me kusht që ata të kontribuojnë në bashkëpunimin universitar transkombëtar dhe/apo në marrjen e masave të përshtatshme të trajnimit. Lektorët, profesorët lëvizës dhe personeli mësimor do të kenë një ngarkesë mësimore të paktën 6 orë mësimdhënie në javë në universitetin pritës.

3) Bursa do t'u jepen gjithashtu studentëve dhe të diplomuarve për trajnim praktik në ndërmarrje tregtare, mjedise kërkimore ose në institucione qeveritare në vendin pritës, me kusht që të bëjnë një plan të përcaktuar dhe të strukturuar.

4) Bursat e studentëve për veprimtaritë e rregullta të semestrit do të jepen për një periudhë minimumi prej 3 muajsh dhe një maksimumi prej 10 muajsh. Qëndrime më të shkurtra do të lejohen për studentët që punojnë për tezat dhe dizertacionet e tyre.

5) Bursat CEEPUS II mund t'u jepen dhe studentëve të regjistruar në një universitet të pranueshëm për CEEPUS II, për të cilët janë bërë ujdj të posaçme studimi jashtë rrjetit CEEPUS II. (Freemovers)

6) Bursat CEEPUS II janë bursa "të plota", domethënë mbulojnë shpenzimet e jetesës, taksat laboratorike sipas rregullit të përgjithshëm në vendin pritës, strehimin dhe sigurimin shëndetësor bazë, kur kjo zbatohet në vendin pritës. Bursat CEEPUS II do të jenë në përputhje me koston e jetesës në vendin pritës dhe do të mbrohen ndaj lëvizjeve të inflacionit.

7) Meqë nuk ka transferim fondesh, bursat CEEPUS II do të paguhën nga vendi pritës, përveç shpenzimeve të udhëtimit, që do të paguhën nga vendi dërgues, ku kjo zbatohet.

8) Shuma e parave të CEEPUS II përcaktohet si "një muaj bursë". Të gjitha Palët Kontraktuese do të njoftojnë për kuotat e tyre për vitin akademik në vazhdim në intervalin mes viteve. Minimumi i kërkuar do të jetë 100 muaj bursa.

9) CEEPUS II nuk do të mbulojë shpenzimet e përgjithshme apo shpenzime që lidhen me qëllime organizative.

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8894, DATË 14.5.2002 “PËR
AGJENCINË E TRAJTIMIT TË KREDIVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

Agjencia është person juridik publik, në varësi të Ministrit të Financave, me seli në Tiranë. Agjencia e ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi.”.

Neni 2

Pika 1 e nenit 14 ndryshohet si më poshtë:

“1. Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë është përgjegjës për drejtimin e Agjencisë. Ai përgjigjet dhe raporton çdo 6 muaj përpara Ministrit të Financave.”.

Neni 3

Në nenin 23 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Vendimi për mbylljen e veprimtarisë së Agjencisë merret nga Këshilli i Ministrave, sipas propozimit të Ministrit të Financave.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Pas mbylljes së Agjencisë, pjesa e mbetur e aktiveve dhe pasiveve administrohet nga Ministria e Financave.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4798, datë 3.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

**L I G J
Nr.9477, datë 9.2.2006**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9228, DATË 29.4.2004
“PËR KONTABILITETIN DHE PASQYRAT FINANCIARE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të

Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në pikën 3 të nenit 20 “Përbërja dhe zgjatja e mandatit” të kreut IV, fjalët “mandati 6-vjeçar” zëvendësohen me fjalët “mandati 4-vjeçar”.

Neni 2

Në pikën 4 të nenit 20 fjalët “ka mandat 4-vjeçar, me të drejtën e rimandatimit”, zëvendësohen me fjalët “ka mandat 3-vjeçar, me të drejtën e rimandatimit”.

Neni 3

Në pikën 5 të nenit 20 bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Në shkronjën “a”, pas fjalëve “në fushën e kontabilitetit” shtohen fjalët “dhe/ose financës”.
2. Shkronjat “b” dhe “c” bashkohen dhe shkronja “b” riformulohet si më poshtë:
“b) të kenë fituar titullin “Profesor” ose gradën shkencore “Doktor shkencash” prej jo më pak se një viti ose të kenë fituar një “Master në kontabilitet dhe/ose financë” prej jo më pak se 3 vjetësh, ose të kenë një përvojë pune me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar mbi 5 vjet, apo me standardet kombëtare të kontabilitetit mbi 7 vjet;”.
3. Shkronja “ç” bëhet “c” dhe shkronja “d” bëhet “ç”.

Neni 4

1. Neni 4 i ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 hyn në fuqi më 1 janar 2008.
2. Deri në këtë datë standardet do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas rregullimeve ekzistuese.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4799, datë 3.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.22, datë 27.2.2006

**PËR MOSMIRATIMIN E RAPORTIT PËR VEPRIMTARINË VJETORE TË KËSHILLIT
KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe të nenit 7 pika 19 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Nuk miratohet raporti i paraqitur nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit për veprimtarinë e këtij të fundit gjatë vitit 2005.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja

REZOLUTË

**PËR RAPORTIN VJETOR TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS
DHE TË TELEVISIONIT PËR VITIN 2005**

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

- duke njohur rolin e KKRT-së si enti i vetëm rregullator në fushën e transmetimeve radio e televizione dhe autoriteti kryesor i zbatimit të legjislacionit shqiptar në këtë fushë;

- duke vlerësuar se veprimtaria njëvjeçare e KKRT-së është në vazhdim të përpjekjeve për rregullimin ligjor të veprimtarisë së mediave, veprimtari kjo e nisur që me krijimin e këtij institucioni;

- duke qenë i ndërgjegjshëm se fillimi i veprimtarisë së këtij autoriteti, ashtu si edhe i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar, u krye në kushtet e ekzistencës së shumë operatorëve në treg dhe të një situatë kaotike në zhvillimin e mediave elektronike;

- duke çmuar si jashtëzakonisht të dobishëm bashkëpunimin e KKRT-së dhe mbështetjen e tij në ekspertizën dhe ndihmën e ofruar nga institucionet ndërkombëtare, si dhe arritjet e realizuara në këtë fushë;

Konstaton se:

- është bërë një hap i pamjaftueshëm në rregullimin e veprimtarisë radio e televizione në Republikën e Shqipërisë;

- operatorët radio e televizione ende nuk e njohin rolin dhe autoritetin e KKRT-së dhe, në përgjithësi, respektimin e detyrimeve ligjore dhe zbatimin e kushteve të licencimit;

- KKRT-ja është nënshtruar ndaj presioneve të ardhura nga grupet e ndryshme të interesit apo nga politika;

- KKRT-ja ka pësuar një dështim të plotë ndaj zbatimit të të drejtave të transmetimit dhe të rregullave të konkurrencës, sidomos pas daljes në emetim të operatorëve pa licencë;

- KKRT-ja është gjetur e paaftë dhe e papërgatitur të veprojë në zbatim të ligjit për të parandaluar shkelësit e tij;

- respektimi i të drejtave të transmetimit dhe i zonave të licencuara të mbulimit vazhdon të mos njihet dhe të mos respektohet qartë nga operatorët.

Duke njohur rëndësinë e zbatimit dhe më tej përmirësimit të legjislacionit në fushën e veprimtarive radio e televizione, si dhe rolin përcaktues të KKRT-së në këtë fushë,

Kuvendi kërkon:

1. Shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit si përgjegjës kryesor për moszbatimin e ligjit “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar.

2. Vendosjen e autoritetit të zbatimit të ligjit në mënyrë të plotë.

3. Reformimin institucional të KKRT-së për ta riorganizuar këtë institucion në mënyrë më funksionale.

REZOLUTË

PËR VEPRIMTARINË E KOMITETIT SHTETËROR TË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE GJATË VITIT 2005

Kuvendi i Shqipërisë, pasi analizoi veprimtarinë e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave gjatë vitit 2005, arriti në konkluzionin:

Mendimi i shumicës:

Konstaton se:

- Ka vonesa në fillimin e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronës, si nga ana e komisioneve vendore, ashtu edhe nga ana e Komitetit Shtetëror, duke e kompromentuar procesin.
- Kompensimi fizik nuk ka filluar, madje komisionet vendore vazhdojnë të mos pranojnë dokumente për kompensimin fizik apo monetar.
- Nuk ka një projekt të qartë për përpilimin e hartës së vlerës së pronës, si dhe një kërkesë zyrtare për fondin e nevojshëm për realizimin e saj, që t'i jetë drejtuar Këshillit të Ministrave.
- Numri i kërkesave ankimore të grumbulluara pranë këtij Komiteti është shumë i madh (1100 kërkesa ankimore), ndërsa numri i përgjigjeve të dhëna i papërfillshëm (45 kërkesa ankimore).
- Me gjithë shtyrjen një herë, nëpërmjet ligjit nr.9388, datë 4.5.2005, të të gjitha afateve kohore, të parashikuara në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004, procesi përsëri rrezikon të mos realizohet, sidomos afati i pranimit të dokumentacionit për kompensim, i cili mbyllet më 15.9.2006, si dhe afati i përfundimit të kompensimit fizik, i cili mbyllet më 31.12.2007, ndërkohë që ende s'kanë filluar.
- Ka tjetërsim të pronës shtetërore në favor të individëve të caktuar, duke u shkelur në mënyrë flagrante ligji nr.9235, datë 29.7.2004 nga disa institucione shtetërore.

Vlerëson se:

- Rezultatet joefektive vijnë nga mosorganizimi i mirë i punës dhe mosvlerësimi sa duhet i procesit të kthimit dhe kompensimit të pronës nga ana e këtij Komiteti.

Tërheq vëmendjen për:

- Një angazhim më të madh të Komitetit në përmbushjen e detyrimeve ligjore, që i ngarkon ata ligji nr.9235, datë 29.7.2004.
- Më shumë rendiment, cilësi dhe përgjegjësi nga ana e komisioneve vendore, si dhe për më shumë kontroll ndaj tyre.
- Mungesën e impenjimit të këtij Komiteti për përpilimin e hartës së vlerës së pronës.
- Një qëndrim pasiv të këtij Komiteti ndaj rasteve të shkeljes së nenit 28 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 nga ana e institucioneve shtetërore në favor të individëve të caktuar.
- Një komunikim të pamjaftueshëm ligjor me të gjitha institucionet shtetërore, që ligji nr.9235, datë 29.7.2004 i detyron, në mënyrë që procesi të shkojë përpara.
- Mungesën e bashkëpunimit me Kuvendin e Shqipërisë, për të vënë në lëvizje dhe përpara përgjegjësisë institucionet shtetërore, që nuk përmbushin detyrimet ligjore.

Kërkon:

- Ndryshimin sa më shpejt të gjendjes së krijuar dhe rritjen e ritmeve të kthimit dhe kompensimit të pronës në përputhje me afatet ligjore.
- KSHKKP-ja të paraqesë zyrtarisht pranë Këshillit të Ministrave projektin dhe preventivin për përpilimin e hartës së vlerës së pronës dhe përfundimin e saj të shpejtë.
- Fillimin e procesit të pranimit të dokumenteve për kompensim.
- Shpejtimin e procesit të vendimmarrjes në përgjigje të ankesave të qytetarëve.
- Institucionet shtetërore, si ZRPP-ja, zyrat e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe, zyrat e urbanistikës në bashki dhe komuna, si dhe drejtoritë e shërbimit pyjor në qarqe që, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, të marrin të gjitha masat, që me vonesat e tyre të mos pengojnë procesin.

Mendimi i pakicës:

- Duke u bazuar në diskutimet dhe opinionet e deputetëve, anëtarë të Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, si dhe të Komisionit për Ekonominë dhe Financat.
- Në përputhje me parimin e kthimit dhe, aty ku sipas ligjit kthimi i pronës është i pamundur, kompensimin e saj.
- Duke njohur rolin e rëndësishëm që ligji i ngarkon KSHKKP-së për zbatimin e procedurave të realizimit të kthimit e kompensimit të pronave ish-pronarëve.

Vlerëson:

- Përpyekjet e KSHKKP-së gjatë vitit 2005 për zbatimin në përgjithësi të detyrave të tij ligjore.
- Përpyekjet për përgatitjen e akteve nënligjore dhe praktikave unifikuese për një zbatim korrekt të ligjit.

Tërheq vëmendjen:

- Për mungesën e rregullores së funksionimit të tij të brendshëm.
- Për mungesën e hartës së tokave të lira të shtetit.
- Për mungesën e gatishmërisë së institucioneve që kanë pasur detyrime ligjore për dhënie informacioni Komitetit.
- Për mungesën e përgjegjësisë dhe profesionalizmit të ndonjë anëtari në komisionet vendore në ushtrimin e detyrave që i ngarkon ligji.

Kërkon për vitin 2006:

Krijimin e një klime bashkëpunimi efektiv të KSHKKP-së me institucionet e tjera shtetërore, të cilat janë burim i informacionit të nevojshëm për mbarëvajtjen e punës, përgatitjen e projektit për realizimin e hartës së vlerës së pronës së paluajtshme, si dhe llogaritjet për fondin e duhur për këtë qëllim si një domosdoshmëri për kompensimin fizik dhe monetar, realizimin në kohë e me cilësi të procesit të njohjes së pronësisë dhe kthimit të pronës.

Tiranë më 2.3.2006

VENDIM

Nr. 416, date 28.2.2006

PËR HEQJEN E LICENCËS SË RADIO “STINËT”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, i përbërë nga:

Halil Lalaj	Kryetar
Lazër Stani	Zv/kryetar
Sefedin Çela	Anëtar
Albert Minga	Anëtar
Agim Duro	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi heqjen e licencës së subjektit radio “Stinët”.

ANKUES: Arqile Ndini, ortak dhe administrator i shoqërisë “Stinët” sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 34 pika 1 dhe neni 137/3, pika c të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr.370, datë 10.11.2005 i KKRT-së,

VËREN SE:

Me vendimin nr.22, datë 23.10.2000, “Mbi licencimin e operatorëve privatë lokalë për

televizion analogjik tokësor dhe radio FM” të KKRT-së, shoqëria “Stinët” sh.p.k. është licencuar për të ushtruar veprimtari radiofonike private vendore për një afat 3-vjeçar.

Në përfundim të afatit ligjor të veprimtarisë radiofonike, në datën 14.10.2003, shoqëria “Stinët” sh.p.k. depozitoi dosjen përkatëse të aplikimit për rinovim licence me nr.736 prot. të KKRT-së. Me shkresën e datës 23.10.2003, z.Arqile Ndini, administrator dhe njëkohësisht njëri nga ortakët e shoqërisë, kërkon mosrinovimin e licencës, duke cituar midis të tjerave : “... se është në proces gjyqësor me ortakun tjetër...”.

Gjithashtu, në datën 30.10.2003, z.Arqile Ndini depoziton njoftimin sipas të cilit:

“Vendimi nr.2, datë 25.10.2003 i Asamblesë së Ortakëve për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së shoqërisë edhe për 4 vite të tjera është i falsifikuar dhe nuk është nënshkruar prej tij”.

Për sa më sipër, me vendimin e saj nr.184, datë 31.10.2003 “Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik Stinët” KKRT-ja vendosi të pezullojë procedurën e rilicencimit për transmetim radio FM vendore private për shoqërinë “Stinët” sh.p.k., deri në zgjidhjen e problemeve ligjore të lindura midis ortakëve.

Pas vënies në dijeni të subjektit për vendimin e mësipërm (me shkresën nr.868 prot., datë 3.11.2003) shoqëria “Stinët” sh.p.k. depoziton pranë KKRT-së, vendimin nr.17518/3, datë 10.11.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, sipas të cilit “Ortaku Kujtim Kapollari si përfaqësues i 70% të kapitalit në datën 5.11.2003 ka shkarkuar administratorin e shoqërisë z.Arqile Ndini. Deri në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve, ortaku Kujtim Kapollari do të kryejë detyrën e administratorit të shoqërisë”. Në këto kushte, me vendimin e saj nr.184/1, datë 14.11.2003, KKRT vendosi të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin “Stinët” sh.p.k. për radion “Stinët”.

Në datën 27.6.2005, z.Arqile Ndini i drejtohet KKRT-së me kërkesën për të bllokuar sa më shpejt të jetë e mundur veprimtarinë e radios “Stinët”, me arsyetimin se:

“... ajo po funksionon në mënyrë të paligjshme me falsitete dhe mashtrime...”. Bashkëlidhur kësaj kërkesë ka paraqitur vendimin nr.1356, datë 26.3.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.108, datë 3.2.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Sipas këtij vendimi gjykata ka vendosur si më poshtë:

- Prishjen me nënvizim të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me nr.17518/2, datë 28.10.2003, (pasi vendimi nr.2 i Asamblesë së Ortakëve rezultoi i falsifikuar dhe jo i nënshkruar nga ortaku z.Arqile Ndini).

- Prishjen me nënvizim të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me nr.17518/3, datë 10.11.2003, (pasi ortaku i shoqërisë z.Arqile Ndini nuk është njoftuar për mbledhje të asamblesë dhe i është mohuar e drejta për të marrë pjesë në vendime).

Në këto kushte, KKRT ndodhet përpara një vendimi gjykate të formës së prerë, që sipas nenit 510/a të Kodit të Procedurës Civile është titull ekzekutiv dhe i detyrueshëm për t’u ekzekutuar. Ky është një fakt i provuar nga gjykata dhe i pakundërshtueshëm përsa i përket pretendimeve të z.Arqile Ndini, që shoqëria “Stinët” sh.p.k. në kërkesën e saj për rinovim licence ka paraqitur të dhëna të rreme, akt ky që bie në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për sa më sipër, në mbledhjen e saj të radhës të datës 29.8.2005, KKRT ra dakord, që subjekti “Radio Stinët”, të ftohet për të biseduar me kryetarin e KKRT-së. Në datën 2.9.2005, në mungesë të z. Kujtim Kapollari, avokati i këtij të fundit nën shoqërinë edhe të përfaqësuesit tjetër z.Bejdo Malo, premtoi që për një kohë shumë të shkurtër do të depozitonin disa dokumente, të cilat sipas tyre do të vërtetonin të kundërtën e asaj që pretendohet nga z.Arqile Ndini.

Pretendimet e tij, z.Arqile Ndini i ka parashtruar përsëri edhe në ankesën e datës 7.10.2005, sipas së cilës : “...Gojarisht më është thënë se vendimi i gjykatës është ankimuar në Gjykatën e Lartë..., por edhe sikur të ishte kështu, fakt që s’është aspak i vërtetë, vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit është i formës së prerë, pavarësisht se paraqitet ankim në Gjykatën e Lartë...”. Ky vendim mund të pezullohet vetëm kur Gjykata e Lartë urdhëron shprehimisht pezullimin deri në shqyrtimin e çështjes, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

Me shkresën nr.3848/1 prot., datë 21.10.2005, në përgjigje të shkresës nr.775, datë 12.10.2005 të KKRT-së, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë sqaron se: “... kundër vendimit civil të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me nr.1356, datë 26.3.2004 dhe vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë me nr.108, datë 3.2.2005, me palë: paditës Arqile Ndini dhe i paditur Kujtim Kapollari nuk është ushtruar

rekurs në Gjykatën e Lartë”.

Gjithashtu, në datën 10.11.2005, nga ana e z.Kujtim Kapollari është depozituar në KKRT, kërkesa me nr. 35 prot., datë 7.11.2005, me objekt: “Shtyrjen e afatit të shqyrtimit të radio “Stinët” pas datës 30.11.2005”. Edhe në këtë kërkesë nuk provohet e kundërta e faktit të vërtetuar me vendimet e gjykatave të përmendura më sipër, që subjekti radiofonik vendor “Stinët” në momentin e rilicencimit ka paraqitur të dhëna të rreme.

Në këto kushte, kjo kërkesë nuk u mor parasysh dhe KKRT, paraprakisht, me vendimin e saj nr.370, datë 10.11.2005 “Mbi vlefshmërinë e licencës së radio “Stinët”, vendosi t’ia heqë licencën këtij subjekti. Lidhur me këtë vendim subjekti radio “Stinët” është njoftuar me shkresën nr.835 prot., datë 11.11.2005. Sipas pikës 2 të vendimit të mësipërm subjekti kishte të drejtë që brenda një afati prej 30 ditësh të jepte mendimet e tij lidhur me vendimin e mësipërm. Këto pretendime janë paraqitur në datën 23.1.2006, në mbledhjen e radhës së KKRT-së, jashtë afatit 30 ditor të përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr.370, datë 10.11.2005 (sipas nenit 137/3 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998).

Konkretisht, edhe në materialet e depozituara nga ana e subjektit radio “Stinët” në mbledhjen e KKRT-së (këto dokumente janë të arkivuara në protokollin e KKRT-së me nr. 67 prot., datë 23.1.2006) nuk paraqitet asnjë pretendim juridik i argumentuar që të hedhë poshtë vendimin nr.370, datë 10.11.2005 të KKRT-së, lidhur me paraqitjen e të dhënave të rreme në kërkesën për rinovimin e licencës. Edhe një kopje kërkesëpadie e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 9.12.2005, nuk përbën kundërshtim ligjor lidhur me sa më sipër. Ky është një proces civil që nuk ka lidhje me themelin e çështjes të vendimit nr.370, datë 10.11.2005 të KKRT-së dhe kjo u përket palëve në këtë proces gjyqësor që të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre.

KKRT vëren se në pretendimet e subjektit radio “Stinët” nuk ka argumente juridike për të kundërshtuar se shoqëria “Stinët” sh.p.k., në kërkesën e saj për rinovim licence ka paraqitur të dhëna të rreme, akt ky që bie në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (neni 34/1).

Në mbështetje të nenit 56/a,b të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit “Palët e interesuara duhet të njoftohen për të gjitha aktet administrative nëpërmjet të cilave merren vendime në lidhje me pretendimet e tyre”, subjekti radio “Stinët” është njoftuar me shkresën nr.150, prot., datë 23.2.2006.

Në këto kushte, KKRT e gjen të drejti kërkesën e ankuesit z.Arqile Ndini për të bllokuar, sa më shpejt të jetë e mundur, veprimtarinë e radio “Stinët”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 34 pika 1 dhe neni 137/3 pika c të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr.370, datë 10.11.2005 të KKRT-së,

VENDOSI:

1. T’i heqë licencën shoqërisë “Stinët” sh.p.k., për radion “Stinët”.
2. Licenca me nr.008/FML, e rinovuar me vendimin nr.184/1, datë 14.11.2003 të KKRT-së bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti radio “Stinët” detyrohet ta ndërpresë menjëherë transmetimin.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.417, datë 27.2.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADIO VENDORE PRIVATE “X”

SUBJEKTIT: SHOQËRIA “X” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim rtv analogjik tokësor në nivel vendor” të miratuar me vendimin nr.355 pika 1, datë 29.8.2005 të KKRT-së, të vendimit nr.405, datë 20.12.2005 të KKRT-së “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radio e televizivë” si dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” të miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë shoqërisë “X” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Fierit.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.418, datë 27.2.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVIZIONIN KABLLOR PRIVAT “IR-GEN”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “IR-GEN” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.375, datë 30.11.2005, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr. 221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “IR-GEN” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës, për të penetruar në qytetin e Gjirokastrës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e saj, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.419, datë 27.2.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “ERI A&A”

SUBJEKTIT: SHOQËRIA “ERI A&A” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr. 375, datë 30.11.2005, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr. 221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “ERI A&A” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës, për të penetruar në qytetin e Ballshit.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e saj, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.420, datë 27.2.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “K.A.M”

PERSONIT FIZIK: Z.BESNIK DELIU

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.375, datë 30.11.2005, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr. 221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, z. Besnik Deliu, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës, për të penetruar në qytetin e Peqinit.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e saj, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.421, datë 27.2.2006

**PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT
“ALI PASHË TEPELENA” (“APT”)**

PERSONIT FIZIK: Z. ELTION THANASI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.375, datë 30.11.2005, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr. 221, datë 30.03.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, z. Eltion Thanasi, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës, për të penetruar në qytetin e Memaliajt.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e saj, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

KËRKESË

Shtetasi Adem Roda, lindur në Ishëm dhe banues në Durrës, kërkon shpalljen të vdekur të djalit të tij Arben Adem Roda, më datën 2 tetor 1997.

KËRKUES
Adem Roda

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë njërive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Për informacione më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 042 555 63; ose 04 267 468

BOTIMET E TJERA TË QENDRËS SË PUBLIKIMEVE:

- 1. REGJISTRAT E NOTERISË sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.**
- 2. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË dhe të gjitha kodet e legjislacionit shqiptar.**
- 3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI të përditësuara për:**

1. PROKURIMIN	1500
PUBLIK.....	
2. NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
.....	
3. SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të).....	1500
4. TAKSAT DHE TATIMET...(suplement	1500
2006).....	
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

DOLI NGA SHTYPI:

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Doli nga shtypi më 8.3.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Mësonjëtorja”
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë